



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Nazim Gafurri 1 (Miladin Popovic)
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

VENDIMI NR.: KPCC/D/R/12/2008
DATA E VENDIMIT: 22/02/2008

URDHËR

(1) Në secilën nga 23 (njëzetë e tri) kërkesat e identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkëngjitur, Komisioni

vendos që

Në ditën e shkatërrimit të pronës së banimit, Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka përmbushur kriteret për vërtetimin e pronësisë mbi pronën e kërkuar dhe mbi ngastrën në të cilën gjendej prona, apo të pjesës së tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(2) Në secilën nga 5 (pesë) kërkesat e regjistruara në pjesën C të listës së bashkëngjitur, Komisioni

vendos që

Në ditën e shkatërrimit të pronës së banimit, Paraqitësi i kërkesës ka përmbushur kriteret për vërtetimin e pronësisë të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar dhe mbi ngastrën në të cilën gjendej prona, apo të pjesës së tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(3) Në secilën nga 28 (njëzetë e tetë) kërkesat të cilat përmenden në paragrafët (1) dhe (2) të mësipërm, Komisioni

urdhëron që

(a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, t'i jepet posedimi i ngastrës në të cilën gjendej prona banesore;

(b) Pala përgjegjëse dhe çdo person tjetër i cili ka uzurpuar ngastrën në të cilën gjendej prona, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri; dhe

(c) Nëse pala përgjegjëse apo çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën dështon të përmbush urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, ata do të dëbohen nga prona;

(4) Në kërkesat Nr. 10111, 15496, 24140, 24516, 47584, 47585 dhe 40599, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të refuzohen për aq sa i takon kërkesës së paraqitësit të kërkesës për kompensim për shkatërrimin e pronës së kërkuar; dhe

(5) Në rastet në të cilat ka më shumë se një pronar, vendimet e mësipërme dhe urdhri nuk ndikon në të drejtat e asnjërit nga bashkë-pronarët përkatës.

ARSYET PËR VENDIMIN

1. Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.)

2. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia, të japë urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë mbi të drejtën e shfrytëzimit në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Komisioni mund të shqyrtoj kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshoj urdhër për kthimin e posedimit. (Shiko nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhresës Administrative nr. 2007/5).

3. Komisioni ka mbajtur seancën e tij të pestë me 19-22 shkurt 2008 në Prishtinë. Totali prej 50 kërkesave për pronën banesore i ish-in paraqitur Komisionit në seancën e tij të pestë, nga Sekretaria Ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës ("Sekretaria Ekzekutive" dhe "KPA", respektivisht), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante.

4. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezentuar kërkesat Komisionit dhe i ka raportuar mbi përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuere të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat për pronësi

5. Bazuar në shqyrtimet e tij të kërkesave dhe të dokumentacionit mbështetës, dhe të informatave të ofruara dhe verifikimit të bërë nga Sekretaria Ekzekutive, totali prej katër kërkesave i është kthyer Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për shqyrtim dhe verifikim shtesë, apo janë tërhequr nga Sekretaria Ekzekutive. Këto kërkesa, të cilat janë të regjistruara në pjesën D të listës së bashkëngjitur, do të shqyrtohen nga Komisioni në kohë të duhur. Vendimi aktual aplikohet për 28 kërkesat që përmenden në dispozitiv të vendimit; tetëmbëdhjetë kërkesat e tjera janë lëndë e vendimit tjetër (KPCC/D/R/11/2008).

6. Në të gjitha këto kërkesa, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësi, dhe të gjitha ishin përkitazi me prona të shkatërruara banesore, me fjalë të tjera shtëpi. Në secilën nga këto kërkesa prona e banimit për të cilën është paraqitur kërkesa ishte shkatërruar pasi që Paraqitësi i kërkesës ka humbur posedimin e pronës dhe nga tani është e zbrazët.

7. Komisioni cek se të gjitha kërkesat janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm të pronave nga ndonjë person apo, edhe ku ka pasur dëshmi të tillë, asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30-ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur se Sekretaria Ekzekutive ka bërë orvatje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, personat të cilët aktualisht mund të kenë uzurpuar pronat, dhe të çdo personi tjetër të cilët kanë mundur të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

8. Në kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, dhe C të listës së bashkëngjitur, Komisioni cek se paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave të tyre për pronësinë, përfshirë fletat poseduese, kontratat mbi shitblerjen, kontratat mbi dhurimin dhe në një rast vendimin mbi trashëgiminë. Komisioni është i kënaqur se këto dokumente me të vërtetë përbëjnë dëshmi të pronësisë. Të gjitha këto dokumente janë vërtetuar nga Sekretaria Ekzekutive si valide.

9. Në shtatëmbëdhjetë kërkesat e regjistruara në pjesën A të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Duke pasur parasysh konstatimin e Komisionit në paragrafin 8 të mësipërm, të gjitha këto kërkesa qëndrojnë të aprovohen. Nr. 13131, paraqitësi i kërkesës ka vdekur pas paraqitjes së kërkesës. Komisioni konsideron se vdekja e Paraqitësit të kërkesës gjatë përpunimit të kërkesës nuk mund të ndikojë në vlefshmërinë e kërkesës. Prandaj vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në

favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet, siç është dhënë më sipër. Ky vendim është pa paragjykim ndaj përcaktimit nga gjykata kompetente se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga Paraqitësi i ndjerë i kërkesës.

10. Në gjashtë kërkesat e regjistruara në pjesën B të listës së bashkëngjitur, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore në pajtim me nenin 1.2 të Aneksit II të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2007/05. Neni 1 i Udhëzimit Administrativ përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshortin/en, fëmijët (e lindur brenda dhe jashtë martese apo të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm, apo personat të cilët janë të obliguar të mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm, pavarësisht nëse ata persona kanë apo nuk kanë qëndruar në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky definicion përfshinë përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve, gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit dhe nipërit/mbesat e bartësit të së drejtës pronësore. Të gjithë paraqitësit e kërkesave në kërkesat e regjistruara në pjesën B të listës së bashkëngjitur përfshihen në këtë definicion dhe rrjedhimisht në secilën nga këto kërkesa vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet, siç është dhënë më sipër.

11. Në pesë kërkesat e regjistruara në pjesën C të listës së bashkëngjitur, Paraqitësi i kërkesës nuk ishte bartës i së drejtës pronësore në ditën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por pohon të ketë trashëguar pronën. Nuk është paraqitur vendim valid mbi trashëgiminë apo ndonjë dëshmi tjetër e dokumentuar nga Paraqitësi i kërkesës i cili do të vërtetonte se Paraqitësi i kërkesës të jetë trashëgimtar i pronës së kërkuar, dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Komisioni nuk ka jurisdiksion të zgjidh çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë. Prandaj vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore qëndron të aprovohet, siç është dhënë më sipër. Ky vendim është pa paragjykim ndaj përcaktimit nga gjykata kompetente se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga bartësi i ndjerë i së drejtës pronësore.

12. Llojet e ndryshme të dokumenteve në të cilat mbështeten Paraqitësit e kërkesave si përkrahje të kërkesave të cilat përmenden në paragrafët 8, 9, 10 dhe 11 të mësipërm, janë të regjistruara në rubrikat përkatëse të listës së bashkëngjitur.

13. Duke pasur parasysh të mësipërmen, Komisioni është i kënaqur, bazuar në dëshmitë që i posedon, se:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka pasur të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo të pjesës së tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) secila kërkesë është e pakontestuar në kuptimin se asnjë person nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës;

- (c) paraqitësi i kërkesës në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (d) secila kërkesë përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

14. Rrjedhimisht, paraqitësit e kërkesave apo bartësit e së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, kanë dëshmuar se përmbushin kriteret për urdhër i cili vërteton pronësinë mbi pronën e kërkuar dhe mbi tokën në të cilën gjendej prona në ditën e shkatërrimit të pronës komerciale. Fakti që prona ishte shkatërruar nuk ndikon në të drejtën e paraqitësve të kërkesave për të pranuar vendim deklarativ nga Komisioni, i cili konfirmon, në ditën e shkatërrimit të pronës, pronësinë mbi tokën në të cilën gjendej prona.

B. Kërkesat për kompensim

15. Në kërkesat Nr. 10111, 15496, 24140, 24516, 47585, 47584 dhe 40599, Paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përpos pronësisë, kompensimin për dëmtim fizik, apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Komisioni nuk ka jurisdiksion mbi kërkesat e tilla. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të refuzohen.

C. Vërejtje përmbledhëse

16. Nga ajo që u tha më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e regjistruara në pjesët A, B dhe C të listës së bashkëngjitur janë të suksesshme dhe urdhri, sa i përket secilës kërkesë, të jepet siç është dhënë më sipër.

17. Në rastet kur më tepër se një kërkesë ka të bëjë me pronën e njëjtë, por megjithatë secila nga kërkesat e tilla konkurruese qëndron të aprovohet, Komisioni ka udhëzuar Sekretarinë Ekzekutive që t'i konsolidojë këto kërkesa dhe të lëshojë një vendim individual për secilën nga kërkesat e tilla konkurruese.

18. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 parasheh që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA13131
KPA40599
KPA15496
KPA47584
KPA47585
KPA24516
KPA14233
KPA14252
KPA31326
KPA14802
KPA15492
KPA36778
KPA21449
KPA21141
KPA21124
KPA13831
KPA13961

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA27525
KPA14603
KPA 14601
KPA10199
KPA13020
KPA13019

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA24140
KPA10111
KPA33067
KPA14031
KPA13100